



MENDO POLITIKISHT

Analizë e programeve të subjekteve
politike në raport me çështjet LGBTI+

ZGJEDHJET PARLAMENTARE

11 MAJ 2025

ALEANCA KUNDËR DISKRIMINIMIT LGBTI
MAJ 2025

Autore: LL.M Dea Nini

Përmbajtja

1.Hyrje.....	3
2. Metodologjia	3
3. Sistemi Zgjedhor që do të Aplikohet në Zgjedhjet e 11 Majit 2025 dhe Subjektet Politike në Garë.....	5
4. Analiza e Programeve Politike të Subjekteve Garuese në Zgjedhjet e 11 Majit 2025 në Raport me Çështjet LGBTI+	8
4.1 Partia Demokratike/ Koalicioni Aleanca për Shqipërinë Madhështore (PD/ASHM)	8
4.2 Lëvizja BASHKË	10
4.3 Lëvizja Atdheu	11
4.4 Koalicioni Euroatlantik (KEA)	12
4.5 Partia Socialiste e Shqipërisë (PS)	13
4.6 Koalicioni “Nisma Shqipëria Bëhet” (NISMA-SHB)	15
4.7 Partia Aleanca Kombëtare Shqiptare (AKSH)	17
4.8 Partia Aleanca Demokratike e Re (ADR).....	18
4.9 Koalicioni Djathtas për Zhvillim (DZH).....	19
4.10 Partia Mundësia	20
4.11 Partia Socialdemokrate (PSD).....	21
5. Përmbledhje e Gjetjeve të Analizës mbi Programet Politike në Lidhje me Çështjet LGBTI+ në Kuadër të Zgjedhjeve Parlamentare të 11 Majit 2025	22

1. Hyrje

Mendo Politikisht 2025 është një iniciativë e ndërmarrë nga Aleanca LGBT për të analizuar dhe bërë publike qëndrimet e subjekteve politike që garojnë në zgjedhjet parlamentare të 11 Majit 2025, lidhur me të drejtat e komunitetit LGBTI+ në vend.

Në prag të zgjedhjeve të përgjithshme të 11 majit, ky material synon të informojë votuesit mbi nivelin e përfshirjes së çështjeve thelbësore të personave LGBTI+ në vend në agjendat politike në garë.

Në një klimë politike ku retorika përjashtuese dhe diskriminuese ndaj personave LGBTI+ vijon të përdoret nga figurat kryesore politike për përfitime elektorale, vota e informuar dhe e ndjeshme ndaj çështjeve të të drejtave të njeriut, me në fokus çështjet që prekin qytetarët LGBTI+, e mbështetur mbi analizën e programeve kryesore politike në garë, mbetet vendimtare.

Theksojmë se ky material informues nuk orienton kurrësesi votuesit drejt një force politike të caktuar, por nxit reflektim të ndërgjegjshëm mbi alternativat aktuale politike, për të ndikuar në një votë më të informuar në zgjedhjet parlamentare që po afrojnë.

2. Metodologjia

Ky material informues është përqendruar në analizën e programeve politike zyrtare të partive dhe koalicioneve pjesëmarrëse në zgjedhjet parlamentare të 11 Majit 2025.

Programet politike (të plota dhe/ose të pjeshshme) të analizuara janë mbledhur dhe shqyrtuar nga burime të hapura si:

- Faqet zyrtare të partive politike;
- Rrjetet sociale dhe platformat digjitale që lidhen me partitë politike/koalicionet që garojnë;
- Komunikimet zyrtare me subjektet garuese politike përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit;

- Materialet promovuese të publikuara nga vetë subjektet politike.

Theksojmë se jo të gjitha subjektet politike pjesëmarrëse në zgjedhje disponojnë një program politik të bërë publik dhe një pjesë e tyre nuk kanë vënë në dispozicion programe zyrtare pavarësisht kërkesave tona të drejtpërdrejta dhe zyrtare për informacion.

Mungesa e transparencës mbi objektivat dhe prioritetet programore përbën një pengesë serioze për vlerësimin objektiv të alternativave politike dhe cenon të drejtën e qytetarëve për një votë të informuar.

Për secilin subjekt janë vlerësuar elementët e mëposhtëm:

- Përmendja e drejtpërdrejtë e komponentëve të orientimit seksual dhe identitetit gjinor si karakteristika të mbrojtura;
- Niveli i përgjithshëm i angazhimit të subjekteve politike ndaj çështjeve të të drejtave të njeriut, barazisë gjinore dhe drejtësisë sociale;
- Propozimet konkrete për reforma ligjore apo politika publike që përfshijnë njohjen ligjore të bashkimeve të të njëjtit seks, njohjen ligjore të identitetit gjinor, edukimin gjithëpërfshirës, mbrojtjen efektive nga dhuna, diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes e motivuar nga statusi LGBTI+, aksesin në shërbime afirmuese;
- Gjuha dhe narrativa që përdoret (përfshirëse, neutrale apo përjashtuese).

Analiza e kryer dhe e përmbledhur në këtë material informues fokusohet në mënyrë primare në përmbajtjen zyrtare të programeve politike dhe qëndrimet e përgjithshme të partive apo koalicioneve në garë, si tregues i vullnetit politik të përgjithshëm për të përfshirë çështjet më me interes për personat LGBTI+ në agjendat qeverisëse dhe jo mbi deklaratat publike individuale të figurave të caktuara politike.

3. Sistemi Zgjedhor që do të Aplikohet në Zgjedhjet e 11 Majit 2025 dhe Subjektet Politike në Garë

E drejta për të votuar dhe për t'u zgjedhur është një e drejtë kushtetuese e çdo shtetasi shqiptar, e sanksionuar nga Neni 45¹ i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili (shkurtimisht) përcakton se:

“Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet. Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.”

Kjo e drejtë përfaqëson një nga shtyllat bazë të demokracisë dhe pjesëmarrjes qytetare në jetën publike.

Për komunitete që historikisht janë përjashtuar dhe diskriminuar nga agjendat politike dhe vendimmarrja, sikurse komuniteti LGBTI+, vota e informuar është një instrument i fuqishëm për të kërkuar barazi, përfaqësim dhe drejtësi.

3.1 Sistemi Zgjedhor i 11 Majit 2025

Zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025 do të zhvillohen për të zgjedhur 140 deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, përmes një sistemi proporcional rajonal, ku Shqipëria ndahet në 12 zona zgjedhore, një për çdo qark. Numri i mandateve për çdo qark përcaktohet në përpjesëtim me numrin e popullsisë së atij qarku.

Sipas ndryshimeve të fundit në Kodin Zgjedhor, në këto zgjedhje do të përdoret një **model i kombinuar i listave të kandidatëve**, me:

¹ **KREU III LIRITË DHE TË DREJTAT POLITIKE Neni 45** (Ndryshuar paragrafi i tretë me ligjin nr. 137/2015, datë 17.12.2015) 1. Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet. 2. Përjashtohen nga e drejta e zgjedhjes shtetasit e deklaruar me vendim gjyqësor të formës së prerë si të paaftë mendërisht. 3. Përjashtohen nga e drejta për t'u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përfundimtar të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, sipas rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në raste përjashtimore dhe të justifikuara, ligji mund të parashikojë kufizime të së drejtës për të zgjedhur të shtetasve që vuajnë dënimin me heqje lirie, ose të së drejtës për t'u zgjedhur para dhënies së një vendimi përfundimtar apo kur shtetasit janë dëbuar për një krim ose për cenim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike. 4. Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.

- **1/3 e listës së mbyllur**, të përcaktuar nga kryetari i partisë dhe që nuk i nënshtrohet votës preferenciale;
- **2/3 e listës së hapur**, ku votuesi mund të zgjedhë një kandidat të preferuar nga radhët e subjektit politik që mbështet.

Fleta e votimit do të ketë dy seksione: një për listën e mbyllur dhe një për listën e hapur. Megjithatë, vota preferenciale e dhënë për një kandidat nga lista e hapur nuk garanton automatikisht renditjen apo zgjedhjen e tij/saj, pasi shpërndarja e mandateve bazohet në vlerën e ashtuquajtur **“herës”** (numri i votave që merr një subjekt politik në një qark, pjesëtuar me numrin e mandateve të fituara nga subjekti politik). Vetëm kandidatët që kalojnë këtë herës, ose në disa raste një prag minimal prej 10,000 votash, arrijnë të fitojnë një mandate parlamentar.

3.2 Risia: Votimi nga Diaspora

Për herë të parë, qytetarët shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të vendit do të kenë të drejtë të votojnë në zgjedhjet parlamentare.

Fletët e votimit do të dërgohen me postë, ndërsa **të gjitha kostot për tarifën postare mbulohen nga shteti shqiptar**. Afati për dorëzimin e listës së kandidatëve është shtyrë në **75 ditë para datës së zgjedhjeve**, për të mundësuar dërgimin në kohë të materialeve zgjedhore.

3.3 Votimi Elektronik

Votimi elektronik do të aplikohet në Njësinë nr. 10 në Tiranë dhe në Bashkinë e Vorës, duke ndjekur praktikën e mëparshme të suksesshme në zgjedhjet vendore të vitit 2023.

3.4 Pragu Elektoral dhe Shpërndarja e Mandateve

Subjektet politike duhet të kalojnë **pragun elektoral prej 5% në nivel qarku** për të fituar të drejtën e përfaqësimit në Kuvend. Ky sistem favorizon subjektet më të mëdha në qarqe me pak mandate dhe vendos sfida shtesë për partitë e vogla dhe koalicionet alternative.

3.5 Subjektet në Garë për Zgjedhjet 2025

Sipas të dhënave të publikuara nga **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)**, për zgjedhjet parlamentare 2025 janë regjistruar një numër i konsiderueshëm partish politike dhe koalicionesh në garë.

Subjektet politike kryesore që garojnë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 janë:

1. **Koalicioni Partia Demokratike - Aleanca për Shqipërinë Madhështore (PD-ASHM)**- Sali Berisha
2. **Partia Lëvizja Bashkë (BASHKË)**- Arlind Qori
3. **Lëvizja Atdheu (LA)**- Kreshnik Osmani
4. **Partia Koalicioni Euroatlantik (KEA)**- Lulzim Basha
5. **Partia Socialiste e Shqipërisë (PS)**- Edi Rama
6. **Koalicioni Nisma Shqipëria Bëhet (NISMA-SHB)**- Adriatik Lapaj
7. **Partia Aleanca Kombëtare Shqiptare (AKSH)**- Elena Kocaqi
8. **Partia Aleanca Demokratike e Re (ADR)**- Edmond Stojku
9. **Koalicioni Djathtas Për Zhvillim (DZH)**- Dashamir Shehi
10. **Partia Mundësia (MUNDËSIA)**- Agron Shehaj
11. **Partia Socialdemokrate (PSD)**- Tom Doshi

Pavarësisht rëndësisë së transparencës dhe llogaridhënies në një proces zgjedhor demokratik, **jo të gjitha subjektet politike në garë kanë publikuar programe politike** apo i janë përgjigjur kërkesave zyrtare për informacion të dërguara nga Aleanca LGBT në lidhje me çshtjet që prekin personat LGBTI+ në Shqipëri.

4. Analiza e Programeve Politike të Subjekteve Garuese në Zgjedhjet e 11 Majit 2025 në Raport me Çështjet LGBTI+

Ky seksion përmbledh vlerësimin e programeve politike të subjekteve kryesore që garojnë në zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025, në raport me përfshirjen ose jo të çështjeve që prekin komunitetin LGBTI+ në vend. Për secilin program politik të publikuar të subjekteve garuese është vlerësuar:

1. Përmendja e drejtpërdrejtë e komponentëve të orientimit seksual dhe identitetit gjinor si karakteristika të mbrojtura;
2. Niveli i përgjithshëm i angazhimit të subjekteve politike ndaj çështjeve të të drejtave të njeriut, barazisë gjinore dhe drejtësisë sociale;
3. Propozimet konkrete për reforma ligjore apo politika publike që përfshijnë njohjen ligjore të bashkimeve të të njëjtit seks, njohjen ligjore të identitetit gjinor, edukimin gjithëpërfshirës, mbrojtjen efektive nga dhuna, diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes e motivuar nga statusi LGBTI+, aksesin në shërbime afirmuese;
4. Gjuha dhe narrativa që përdoret (përfshirëse, neutrale apo përjashtuese).

Analiza fokusohet në dokumentet programore zyrtare dhe komunikimet publike të disponueshme deri në datën e hartimit të këtij materiali.

4.1 Partia Demokratike/ Koalicioni Aleanca për Shqipërinë Madhështore (PD/ASHM)

Kryetar: Sali Berisha

Statusi i programit politik: *Nuk ka një program të mirëfilltë, por disa pika programatike të përgjithshme të bëra publike, pa përmbajtje specifike lidhur me të drejtat LGBTI+.*

Vlerësimi i përmbajtjes programore: Programi politik i këtij koalicioni është përqendruar në fusha si ekonomia, sipërmarrja, arti, kultura, sporti dhe mjedisi. Megjithatë, nuk përmban asnjë referencë ndaj çështjeve të barazisë gjinore, të drejtave të njeriut, drejtësisë sociale apo mbrojtjes së personave LGBTI+. Nuk ka asnjë përmendje të orientimit seksual, identitetit gjinor

apo masave për parandalimin e diskriminimit. Narrativa është e ndërtuar mbi parime konservatore dhe tradicionaliste, duke vendosur theksin te “Zoti, Familja dhe Kombi”.

Statuti zyrtar i Partisë Demokratike (miratuar më 11 dhjetor 2021) përfshin referenca të përgjithshme ndaj “lirive dhe të drejtave themelore të njeriut” dhe “barazisë në shanse”, por nuk përmend në asnjë moment barazinë gjinore, diskriminimin apo të drejtat e personave LGBTI+ dhe grupimeve të tjera të marginalizuara. Ky statut nuk parashikon mekanizma për të garantuar përfshirjen, përfaqësimin apo mbrojtjen e grupeve të marginalizuara në jetën politike të partisë.

Qëndrimet publike dhe veprimet institucionale: Përfaqësues të këtij koalicioni, përfshirë liderin kryesor, janë shprehur në mënyrë të vazhdueshme kundër të drejtave të personave LGBTI+, duke përdorur gjuhë përjashtuese dhe stigmatizuese. Retorika politike është ndërtuar mbi moton “Zoti, Familja dhe Kombi”, e cila përjashton në mënyrë të qartë çdo formë alternative të jetesës familjare apo përfaqësimit gjinor.

Gjatë vitit 2025 përfaqësues të PD-së kanë **propozuar një projektligj regresiv**, i cili synon të sanksionojë në mënyrë të qartë se **në Shqipëri ekzistojnë dhe njihen ligjërisht vetëm dy gjini, mashkull dhe femër**, duke përjashtuar dhe mohuar juridikisht ekzistencën e personave transgjinorë dhe interseks. Ky propozim përbën një përpjekje të drejtpërdrejtë për të kufizuar të drejtat themelore të njeriut dhe për të vendosur pengesa strukturore ndaj njohjes ligjore të identitetit gjinor.

Përfundim: Koalicioni PD/ASHM nuk ofron asnjë garanci për mbrojtjen apo avancimin e të drejtave të personave LGBTI+ në Shqipëri. Përmes qëndrimeve publike përjashtuese dhe përpjekjeve legislative regresive, ky koalicion përfaqëson një nga rreziqet më serioze për dinjitetin, sigurinë dhe të drejtat themelore të komunitetit LGBTI+ në Shqipëri.

4.2 Lëvizja BASHKË

Kryetar: Arlind Qori

Statusi i programit politik: *Program i plotë qeverisës publik, me përfshirje të përgjithshme të çështjeve të barazisë dhe diskriminimit, përfshirë orientimin seksual dhe përkatësitë identitare.*

Vlerësim i përmbajtjes programore: Lëvizja BASHKË është i vetmi subjekt politik në këto zgjedhje që përmend në mënyrë eksplicite orientimin seksual dhe përkatësitë identitare si kategori që duhet të mbrohen nga diskriminimi. Në seksionin për drejtësinë sociale, programi thekson:

“Pabarazitë nuk kufizohen vetëm në aspektin social dhe ekonomik, por prekin edhe përkatësitë identitare. Në një shoqëri demokratike dhe të drejtë, askush nuk duhet të përjashtohet apo të diskriminohet për shkak të gjinisë, etnisë, besimit fetar, përkatësisë krahinore, **orientimit seksual**, etj.”

Ky është një qëndrim i qartë për përfshirje dhe mosdiskriminim të personave LGBTI+ edhe pse i shprehur në mënyrë të përgjithshme dhe i pa shoqëruar me propozime të tjera konkrete për politika afirmuese që adresojnë nevojat specifike të komunitetit LGBTI+.

Drejtësia sociale dhe barazia gjinore: Programi i Lëvizjes BASHKË është ndërtuar mbi një filozofi politike që synon kthimin e shtetit në një instrument të drejtësisë sociale, përmes rritjes së shërbimeve publike dhe garantimit të aksesit universal në arsim, shëndetësi, strehim dhe punësim.

Qëndrimi politik dhe narrative publike: Lëvizja BASHKË pozicionohet si një forcë e majtë me orientim drejt rishpërndarjes, barazisë dhe pjesëmarrjes qytetare. Gjuha publike e përdorur është përfshirëse dhe me theks të fortë emancipues, megjithatë në program mungon konkretizimi i politikave për komunitetet vulnerabël dhe masat specifike afirmative.

Përfundim: Lëvizja BASHKË është subjekti i vetëm politik në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 që përfshin orientimin seksual dhe përkatësitë identitare si kategori të mbrojtura nga diskriminimi në programin e saj zyrtar. Edhe pse nuk ofron masa të tjera të detajuara që

targetojnë çështjet kryesore të personave LGBTI+, përmendja eksplicite dhe pozitive e orientimit seksual dhe qasja e përgjithshme për drejtësi sociale dhe respektim universal të të drejtave të njeriut e pozicionojnë këtë forcë politike ndër alternativat më përfshirëse ndaj çështjeve LGBTI+ në peisazhin aktual zgjedhor.

4.3 Lëvizja Atdheu

Kryetar: Kreshnik Osmani

Statusi i programit politik: *Program i pjesshëm, pa dokument të plotë të publikuar. Pozicionim konservator dhe theks nacionalist në komunikimet publike.*

Vlerësim i përmbajtjes programore: Lëvizja Atdheu është një forcë e re politike që vetëpozicionohet si një parti **konservatore e qendrës demokratike**, me një diskurs të bazuar fort mbi **vlerat kombëtare, besimin dhe traditën**. Në deklaratat e deritanishme, theksi vihet mbi rindërtimin e një shteti të së drejtës, edukimin me kulturë perëndimore dhe mbrojtjen e trashëgimisë shqiptare si themel i modernizimit kombëtar.

Partia artikulon një **kritikë të fortë ndaj sistemit aktual politik dhe moral**, duke e përshkruar tranzicionin shqiptar si dekadent dhe të kapur nga korrupsioni, populizmi dhe humbja e vlerave. Në këtë kontekst, ajo shpreh aspiratën për një "shoqëri të virtytshme" që ndërtohet mbi "besimin dhe shpirtin fisnik të kombit".

Megjithatë, kjo parti nuk ka ende një program politik të publikuar dhe në pikat programore të publikuara mungon çdo referencë ndaj të drejtave të njeriut, barazisë gjinore dhe çështjeve që lidhen me diskriminimin ndaj komuniteteve të marginalizuara, përfshirë personat LGBTI+. Gjuha e përdorur lë të kuptohet se kjo parti përfaqëson një **qasje konservatore dhe esencialiste ndaj kombit dhe familjes**, pa hapësirë për konceptet thelbësore të barazisë, diversitetit dhe gjithëpërfshirjes.

Qëndrimi politik dhe narrative publike: Narrativa e përdorur është e ngarkuar me **simbolikë nacionaliste dhe referenca morale** dhe nuk artikulon një vizion të qartë për përfaqësimin e

grupeve vulnerabël ose për ndërtimin e një shteti social gjithëpërfshirës. Termat si “psikologji antikombëtare”, “populistë dhe avokatë të së keqes” apo “emigrimi i trurit”, tregojnë një orientim ideologjik që fokusohet në rendin, dinjitetin kombëtar dhe rikthimin e hierarkive të supozuara morale, më shumë sesa në barazi dhe të drejta.

Përfundim: Lëvizja Atdheu nuk ka publikuar një program politik të plotë dhe nuk ofron asnjë referencë për të drejtat e njeriut apo barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale në narrativën e saj publike. Diskursi publik dhe vetëpozicionimi si forcë konservatore sugjerojnë një **mungesë të vullnetit politik për të adresuar çështjet që prekin personat LGBTI+ dhe grupet e tjera të marginalizuara në Shqipëri.**

4.4 Koalicioni Euroatlantik (KEA)

Kryetar: Lulzim Basha

Statusi i programit politik: *Program i pa publikuar; komunikimi politik i deritanishëm fokusohet në çrrënjosjen e korrupsionit dhe reformimin e shtetit, pa përfshirje të qartë të çështjeve të të drejtave të njeriut apo barazisë.*

Vlerësim i përmbajtjes programore: Koalicioni Euroatlantik, i udhëhequr nga Lulzim Basha, ka si bosht të narrativës së tij **luftën kundër korrupsionit, rikthimin e integritetit në qeverisje dhe forcimin e institucioneve të drejtësisë.** Riorganizimi i këtij poli politik pas ndarjes nga Partia Demokratike synon të ofrojë një alternativë më të moderuar dhe pro-perëndimore.

Komunikimi publik i KEA-së është fokusuar në:

- **Luftën kundër korrupsionit dhe klientelizmit**, si pengesë kryesore për zhvillimin demokratik dhe integrimin evropian;
- **Rikthimin e meritokracisë dhe ndërtimin e një shteti funksional**, që i shërben qytetarëve dhe jo interesave të ngushta politike;
- **Zhvillimin ekonomik të ndershëm** dhe garantimin e shtetit të së drejtës.

Qëndrimi i kësaj force politike **deri më sot nuk përfshin asnjë referencë të drejtpërdrejtë mbi çështje që lidhen me barazinë gjinore, orientimin seksual, identitetin gjinor apo të drejtat e komunitetit LGBTI+.**

Qëndrimi politik dhe narrativa: Megjithëse më e moderuar se Partia Demokratike e Berishës, narrativa e KEA-s mbetet **e kufizuar në termat e reformës shtetërore dhe luftës kundër korrupsionit**, pa adresuar dimensionin social dhe çështjet e të drejtave të njeriut. Vlerat euro-atlantike përmenden shpesh në retorikat e kësaj force politike, por ato nuk konkretizohen në politika për barazi apo përfaqësim të grupeve të marginalizuara.

Përfundim: Koalicioni Euroatlantik paraqet një **agjendë të përqendruar në ristrukturimin institucional dhe luftën kundër korrupsionit**. Në mungesë të një programi të shkruar dhe në mungesë të deklaratave publike përfshirëse, **ky subjekt nuk përbën një alternativë të qartë për votuesit LGBTI+ që kërkojnë përfaqësim aktiv dhe efektiv politik.**

4.5 Partia Socialiste e Shqipërisë (PS)

Kryetar: Edi Rama

Statusi i programit politik: *Deri në momentin e analizës, Partia Socialiste nuk ka publikuar një program të plotë politik për zgjedhjet e 11 Majit 2025. Qasja e deritanishme është përqendruar në retorikën e vazhdimësisë së qeverisjes dhe integritetit evropian, pa angazhime të reja ndaj të drejtave të njeriut dhe barazisë.*

Vlerësim i përmbajtjes programore dhe performancës qeverisëse: Partia Socialiste ka qenë forca qeverisëse e vendit për tri mandate të njëpasnjëshme (2013–2025). Gjatë kësaj periudhe janë miratuar disa dokumente strategjike në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit, si **Planet Kombëtare të Veprimit për Personat LGBTI+**, si dhe janë krijuar struktura institucionale për barazinë gjinore dhe për mbrojtjen nga diskriminimi. Po kështu, është punuar për një Protokoll Mjekësor për trajtimin hormonal të personave transgjinorë të rritur, i cili mbetet i pamiruar ende.

Megjithatë, gjatë këtyre tri mandateve, PS ka treguar një pasivitet të vazhdueshëm dhe mungesë të qartë vullneti politik për të avancuar në mënyrë të prekshme dhe të qenësishme të drejtat e komunitetit LGBTI+ në vend.

Konkretisht:

- Nuk ka bërë asnjë përpjekje për të garantuar njohje ligjore të bashkëjetesës apo martesës së çifteve të të njëjtit seks, pavarësisht rekomandimeve ndërkombëtare të përsëritura;
- Nuk ka iniciuar ose mbështetur rregullime ligjore për njohjen e identitetit gjinor për personat transgjinorë, duke i lënë të pambrojtur përballë diskriminimit dhe dhunës;
- Nuk ka përfshirë çështjet LGBTI+ në mënyrë të qëndrueshme në kurrikulat arsimore;
- Zbatimi i Planeve Kombëtare të Veprimit për personat LGBTI+ ka qenë minimal, me mungesë të buxheteve të dedikuara, mungesë të monitorimit dhe matjes së ndikimit dhe vëmendje të ulët institucionale, gjetje e theksuar në mënyrë të përsëritur nga një sërë instrumentash ndërkombëtare të të drejtave të njeriut;
- Komunikimi publik i PS-së mbi çështjet LGBTI+ ka qenë thujse inekzistent dhe i përqëndruar vetëm në deklarata ndërkombëtare, pa reagime publike në nivel kombëtar.

Qëndrimi politik dhe narrativa: Ndërsa PS pozicionohet si forcë e qendrës pro-evropiane, në praktikë ka shmangur çdo përballje të drejtpërdrejtë politike me temat që prekin komunitetin LGBTI+, duke i lënë jashtë diskursit publik. Përgjatë tri mandateve qeverisëse, partia ka zgjedhur një neutralitet institucional, që nuk garanton mbrojtje, nuk ofron përfaqësim efektiv dhe nuk sjell ndryshime të prekshme.

Përfundim: Partia Socialiste, megjithëse ka krijuar disa struktura institucionale dhe kuadre ligjore në letër, nuk ka shfaqur vullnet të qartë politik për të garantuar barazi ligjore dhe substanciale për komunitetin LGBTI+ në Shqipëri.

Një tregues i drejtpërdrejtë i performancës qeverisëse në raport me çështjet e qytetarëve LGBTI+ është se **88%** e personave LGBTI+ që morën pjesë në pyetësin vjetor të Aleancës

LGBTI për periudhën 2024-2025 deklaruan se dëshirojnë të largohen nga Shqipëria, përqindja më e lartë e regjistruar ndonjëherë gjatë 12 viteve të fundit.

Retorika e Partisë Socialiste në këtë fushatë zgjedhore është përqendruar në premtimin për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian brenda mandatit të katërt qeverisës. Kjo nënkupton hapjen dhe përmbushjen e **kapitujve kyç të acquis**, si **Kapitulli 23 për të drejtat themelore** dhe **Kapitulli 19 për politikën sociale**, të cilët përfshijnë qartësisht **angazhimin për njohjen ligjore të personave LGBTI+ dhe mbrojtjen e tyre nga diskriminimi.**

Megjithatë, në mungesë të një programi politik të publikuar dhe në mungesë të një pozicionimi të qartë publik të PS-së mbi çështjet LGBTI+, situata mbetet e paqartë. Ky mosqartësim është një tregues i mungesës së përgjegjshmërisë politike për përfshirjen e barabartë të të gjithë qytetarëve në programin qeverisës, përfshirë komunitetin LGBTI+.

4.6 Koalicioni “Nisma Shqipëria Bëhet” (NISMA-SHB)

Kryetar: Adriatik Lapaj

Statusi i programit politik: *Programi elektorale për zgjedhjet e 11 majit 2025 është publikuar dhe është i fokusuar kryesisht në reforma institucionale, qeverisje të mirë dhe drejtësi shoqërore.*

Vlerësim i përmbajtjes programore: Programi politik i koalicionit “Nisma Shqipëria Bëhet” synon rikthimin e besimit të qytetarëve në shtet përmes garantimit të sundimit të ligjit, transparencës dhe rishpërndarjes më të drejtë të pasurisë kombëtare.

Programi propozon masa për:

- reformën në drejtësi dhe shërbimin civil;
- arsim cilësor dhe inovacion;
- ndarje më të drejtë të taksave dhe rritje të ekonomisë prodhuese;
- decentralizim dhe fuqizim të demokracisë vendore;
- mbrojtje të mjedisit dhe përmirësim të shëndetësisë.

Megjithatë, në gjithë programin elektorale nuk ka asnjë referencë specifike për të drejtat e personave LGBTI+, për orientimin seksual, identitetin gjinor apo masat kundër diskriminimit mbi këto baza. Referencat mbi tema si **barazia gjinore, përfshirja e grupeve të marginalizuara apo edukimi gjithëpërfshirës** mungojnë plotësisht. E vetmja referencë e përgjithshme ndaj të drejtave të njeriut është përmes angazhimit për ndërtimin e një “shoqërie të drejtë”, por pa përmbajtje konkrete mbi mbrojtjen e grupeve vulnerabël.

Qëndrimi politik dhe narrativa publike: Krahas mungesës së angazhimeve për barazi, kryetari Adriatik Lapaj, ka publikuar në rrjetet sociale një qëndrim ku thuhet: **“Rroftë babai, rroftë nëna. Neveri për të gjithë ata që kërkojnë të cenojnë themelet e familjes shqiptare.”**

Kjo deklaratë mbart qartësisht një qëndrim refuzues ndaj modeleve jo-heteronormative familjare, përfshirë familjet me prindër të të njëjtit seks, dhe rikonfirmon një narrativë përjashtuese që nuk e konsideron komunitetin LGBTI+ si pjesë të barabartë të shoqërisë shqiptare.

Në një klimë politike ku retorika homofobike dhe transfobike janë tejet prezente gjatë fushatës zgjedhore, një qëndrim i tillë i udhëheqësit të një subjekti të ri politik nuk është vetëm zhgënjyes, por edhe sinjalizues për mungesën e çdo garancie për respektimin dhe garantimin e të drejtave të njeriut pa dallim për çdo qytetar shqiptar në një qeverisje të mundshme të ardhshme nga kjo forcë politike.

Përfundim: Megjithëse Nisma “Shqipëria Bëhet” përfaqëson një alternativë të re politike me theks në transparencë dhe drejtësi sociale, mungesa totale e referencave ndaj të drejtave të njeriut dhe specifikisht të drejtave të personave LGBTI+ në programin e saj politik, së bashku me deklaratat publike përjashtuese të udhëheqësit të saj, e pozicionon këtë subjekt politik si jo-miqësor ndaj barazisë dhe gjithëpërfshirjes.

4.7 Partia Aleanca Kombëtare Shqiptare (AKSH)

Kryetare: Elena Kocaqi

Statusi i programit politik: Partia Aleanca Kombëtare Shqiptare nuk ka publikuar një program politik të plotë në formë dokumenti për zgjedhjet parlamentare të vitit 2025. Qëndrimet e saj janë artikuluar përmes pikave të publikuara në faqen zyrtare të partisë nën seksionin “Programi Politik”, si dhe përmes deklaratave publike të kryetares.

Vlerësim i përmbajtjes programore: Sipas informacionit të bërë publik deri tani mbi pikat programore të AKSH-së, kjo parti synon:

- Ndërtimin e një shteti demokratik ku sovrani është populli përmes referendumeve dhe zgjedhjeve të drejtpërdrejta për deputetët;
- Respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut në aspektin klasik: pronë, liri mendimi dhe proces i rregullt ligjor;
- Vendosjen e meritokracisë në administratë dhe përfshirjen e ekspertizës në hartimin e politikave publike;
- Reforma të thella në sistemin arsimor sipas modeleve ndërkombëtare (Japoni, Finlandë, Singapor);
- Prioritet të lartë për mbrojtjen e nënës dhe fëmijës dhe përcaktimin me ligj të minimumit jetik;
- Mbështetje për mirëqenien sociale përmes menaxhimit të zgjuar të burimeve publike.

Qëndrimi ndaj çështjeve të barazisë dhe të drejtave të personave LGBTI+: Deri sot, AKSH-ja nuk ka mbajtur asnjë qëndrim publik të dokumentuar në mbështetje të barazisë gjinore, të drejtave të njeriut në kuptim thelbësor dhe të drejtave të personave LGBTI+. AKSH është vetëpozicionuar në spektrin konservator, duke i dhënë përparësi konceptit të familjes tradicionale, vlerave kombëtare dhe rolit të grave si nëna dhe edukatore, çka nënkupton një kuadër ideologjik që nuk i përfshin apo mbron efektivisht format alternative të jetës familjare dhe as konceptet e identitetit gjinor dhe orientimit seksual.

Narrativa politike: Fokusi i partisë mbetet te demokracia përfaqësuese direkte, sovraniteti popullor dhe zhvillimi ekonomik e kulturor. Ndërsa përmenden “të drejtat e njeriut”, ato

kuptohen në formën klasike dhe nuk konkretizohen në lidhje me çështje të barazisë, gjithëpërfshirjes apo anti-diskriminimit. Retorika mbetet e kufizuar në vlera konservatore që nuk nxisin përfaqësimin apo mbrojtjen e grupeve vulnerabël dhe specifikisht komunitetit LGBTI+.

Përfundim: Pozicionimi konservator i Partisë Aleanca Kombëtare Shqiptare dhe përjashtimi i plotë i çështjeve të barazisë nga platforma e saj politike, bëjnë të qartë se kjo forcë politike nuk ofron garanci për përfaqësimin apo mbrojtjen efektive të të drejtave të personave LGBTI+ në vend.

4.8 Partia Aleanca Demokratike e Re (ADR)

Kryetar: Edmond Stojku

Statusi i programit politik: ADR ka publikuar një program të përgjithshëm politik, ekonomik dhe social, i cili përbën bazën e angazhimeve të saj për zgjedhjet parlamentare të vitit 2025. Programi është i përqendruar në sfidat ekonomike të vendit dhe propozon ndërhyrje strukturore në fusha si administrata publike, punësimi, tregu i brendshëm dhe zhvillimi rural.

Qëndrimet politike dhe programore: Programi i ADR-së fokusohet në temat kryesore të mëposhtme:

- **Luftë pa kompromis kundër korrupsionit** dhe informalitetit ekonomik;
- **Rimodelim i administratës publike** dhe shtetërore mbi bazë meritokracie;
- **Reforma fiskale**, përfshirë rikthimin e taksës së sheshtë 10%;
- **Rritje e prodhimit vendas** dhe mbrojtje e tregut të brendshëm nga importet masive;
- **Përmirësim i sistemit të arsimit**, duke përputhur përmbajtjen me nevojat e tregut të punës dhe përmes eliminimit të korrupsionit në mësimdhënie;
- **Përgjegjësia e shtetit për mirëqenien sociale**, përfshirë minimumin jetik, rritjen e pensioneve dhe dinjitetin e punonjësve në sektorin publik;
- **Adresimi i krizës së emigracionit dhe ikjes së trurit**, përmes incentivave ekonomike dhe rigjallërimit të industrive të brendshme.

Qëndrimi ndaj çështjeve të barazisë dhe atyre LGBTI+: Programi politik i ADR-së **nuk përmend në asnjë moment çështje që lidhen me barazinë gjinore, mbrojtjen nga diskriminimi, apo të drejtat e komunitetit LGBTI+.** Gjithashtu, nuk ofron asnjë qasje ndaj drejtësisë sociale për komunitetet e marginalizuara apo grupet vulnerabël. Pavarësisht se në program artikullohet nevoja për "ndërhyrje të ndershme dhe afatgjata", mungesa totale e referencave ndaj çështjeve të të drejtave të njeriut, sugjeron mungesë vullneti politik për t'i adresuar ato.

Narrativa politike: ADR-ja ka një program të artikuluar fort në drejtim të **reformave sistemike, përgjegjshmërisë fiskale dhe rimëkëmbjes ekonomike të qëndrueshme.** Ajo synon një shtet më efikas dhe të drejtë për qytetarin e zakonshëm, por qasja mbetet strukturaliste dhe nuk përfshin qartazi dimensionet e **përfaqësimit, përfshirjes sociale apo barazisë në të drejta** për grupet më të ekspozuara ndaj diskriminimit.

Përfundim: Pavarësisht gjuhës reformuese dhe qëllimeve për ndershmëri institucionale, programi i ADR-së nuk ofron garanci për përfshirjen e të drejtave të personave LGBTI+ në axhendën e saj politike dhe as nuk i përmend këto çështje. Në këto kushte, kjo forcë politike mbetet jashtë listës së aktorëve politikë që adresojnë realisht çështjet e komunitetit LGBTI+ në Shqipëri.

4.9 Koalicioni Djathtas për Zhvillim (DZH)

Koalicioni "Djathtas për Zhvillim", i përbërë nga Lëvizja për Zhvillim Kombëtar dhe partia "Djathtas 1912", garon në zgjedhjet e 11 majit 2025 me drejtues Dashamir Shehin dhe Enkelejd Alibeajn. Ky subjekt politik është pozicionuar qartësisht në spektrin e djathtë të qendrës, duke ofruar një platformë konservatore dhe teknokrate që e distancon veten nga retorika populiste e partive të mëdha.

Programi i tyre, edhe pse nuk është publikuar në mënyrë të plotë si dokument politik, është artikuluar nëpërmjet deklaratave në media dhe në fushatën elektorale. Narrativa e këtij koalicioni fokusohet kryesisht në reforma të shtetit të së drejtës, rritje të pensioneve dhe pagave, kompensim të pronarëve dhe ish të përndjekurve politikë, zhvillim rural dhe bujqësor

dhe garantimin e sigurisë përmes krijimit të një Xhandarmërie Kombëtare. Po ashtu, Koalicioni ka shprehur mbështetje për integrimin evropian dhe reformimin e sistemit arsimor.

Në raport me të drejtat e njeriut dhe çështjet që prekin komunitetin LGBTI+, nuk ka asnjë referencë publike të identifikuar në qëndrimet, fjalimet apo prioritetet e komunikimit të tyre. Po ashtu, nuk janë adresuar në asnjë moment çështje si barazia gjinore, përfshirja sociale, apo lufta kundër diskriminimit me në fokus grupimet e marginalizuara.

Duke qenë një koalicion i pozicionuar në të djathtën tradicionale, që artikullohet rreth vlerave të shtetit të vogël, meritokracisë dhe përfaqësimit serioz të klasës së mesme teknokrate, mungesa e referencave të qarta mbi të drejtat e grupeve të marginalizuara dhe specifikisht personave LGBTI+, sugjeron një qasje të distancuar dhe potencialisht përjashtuese.

4.10 Partia Mundësia

Programi elektoral i Partisë Mundësia nuk përmban asnjë referencë të drejtpërdrejtë ndaj të drejtave të komunitetit LGBTI+, diskriminimit mbi bazë orientimi seksual apo identiteti gjinor, barazisë gjinore apo çështjeve të ndërthurura me të drejtat e grave, të rinjve, apo grupimeve të marginalizuara.

Fokusi i programit qëndron te reforma ekonomike, lufta kundër korrupsionit, digjitalizimi dhe efikasiteti i administratës, depolitizimi i arsimit, forca e shtetit ligjor dhe investimet në teknologji. Programi nënvizon rëndësinë e meritokracisë dhe ofrimit të mundësive për individët që duan të ndërtojnë jetën e tyre "pa pengesa nga shteti", por nuk i adreson nevojat specifike të grupeve të marginalizuara.

Në fushën e drejtësisë, partia parashikon forcimin e hetimit financiar, ndëshkimin e korrupsionit dhe rritjen e transparencës në tendera, por nuk përmend mbrojtjen nga diskriminimi apo përfshirjen e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Në përfundim, Partia Mundësia nuk paraqet asnjë angazhim konkret për përfshirjen sociale, ligjore apo ekonomike të komunitetit LGBTI+ dhe nuk ka referenca për përfaqësimin apo mbrojtjen e grupeve të nënpërfaqësuar.

4.11 Partia Socialdemokrate (PSD)

Programi politik i Partisë Socialdemokrate për zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025 përqendrohet në politika sociale dhe fuqizim ekonomik, me një theks të veçantë në drejtim të barazisë gjinore dhe përmirësimit të kushteve për gratë. PSD propozon krijimin e një **Fondi Kombëtar për Gratë Sipërmarrëse** në vlerën prej 10 milionë eurosh, si dhe shërbime të posaçme falas për gratë e dhunuara, që përfshijnë ndihmë juridike, psikologjike dhe ndërtimin e strehëzave. Programi përfshin gjithashtu masa për uljen e hendekut gjinor në paga dhe pensione, trajtim me përparësi për gratë me aftësi të kufizuara, si dhe zgjerim të shërbimeve publike mbi shëndetin e grave përmes një programi kombëtar depistimi për sëmundjet më të zakonshme.

Megjithatë, PSD nuk përfshin asnjë përmendje të drejtpërdrejtë të çështjeve LGBTI+ në programin e saj politik. Diskriminimi mbi baza të tjera përveç gjinisë nuk trajtohet si çështje në vetvete dhe mungojnë angazhimet për reforma legjislative apo mbështetje institucionale që adresojnë nevojat e komunitetit LGBTI+. Në këtë linjë, PSD rreshtohet ndër partitë që nuk e kanë përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë çështjen e barazisë për personat LGBTI+ në programin e tyre elektoral, pavarësisht përkushtimit të shprehur për barazi gjinore dhe drejtësi sociale.

5.Përmbledhje e Gjetjeve të Analizës mbi Programet Politike në Lidhje me Çështjet LGBTI+ në Kuadër të Zgjedhjeve Parlamentare të 11 Majit 2025

Subjekti Politik	A ka përmendje direkte të çështjeve LGBTI+ në Programin Politik?	A shfaqet angazhim specifik ndaj aspekteve të tjera të të drejtave të njeriut?	Narrativa dhe Qasja e përmbledhur në fjalë kyçe
PD / ASHM	Jo	Jo	Përrjashtuese, konservatore, regressive ndaj të drejtave LGBTI+.
Lëvizja BASHKË	Po	Po	Përfshirëse, emancipuese, majtiste
Lëvizja Atdheu	Jo	Jo	Konservatore, esencialiste.
Koalicioni Euroatlantik (KEA)	Jo	Jo	Reformiste, teknokratike.
Partia Socialiste (PS)	Jo	Po, por ka mungesë implementimi.	Narrativë shmangëse ndaj çështjeve LGBTI+, qasje aktive pro euro-integruese.
Nisma SHB	Jo	Jo	Reformiste, por përrjashtuese ndaj çështjeve LGBTI+.
AKSH	Jo	Jo	Konservatore, tradicionaliste
ADR	Jo	Jo	Narrativë ekonomike, pa fokus social.
Djathtas për Zhvillim	Jo	Jo	Teknokratike, pa përfshirje të çështjeve të të drejtave të njeriut.
Partia Mundësia	Jo	Jo	Narrativë thellësisht ekonomike, pa fokus te të drejtat e njeriut.
PSD	Jo	Po, kryesisht çështjet gjinore.	Social-demokrate, politika gjinore dhe të drejtësisë

			sociale, por nuk ka përmendje të çështjeve LGBTI+.
--	--	--	--



ALEANCA LGBTI